



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 18

Datë: 11. 02. 2021. Ora: 11:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Valdete Daka, kryetare e KQZ - së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Eshref Vishi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Artan Asllani.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1.** Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;
- 2.** Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja nr. 8/2021
- 3.** Aktivitetet e SKQZ-së
- 4.** Aktivitetet e ZRPPC-së

-Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për akreditim të vëzhguesve

- 5.** Raport i Këshillave të KQZ-së:

-Këshilli për Operacione Zgjedhore

-Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Operacional për ditën e zgjedhjeve, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2021

- Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimeve të KVV-ve sipas komunave përkatëse, për zgjedhjet e parakoheshme për Kuvendin e Kosovës 2021

-Këshilli për Informim Publik

Informatë rreth aktiviteteve të Informimit Publik

6.Të ndryshme.

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

Valdete Daka: E hapim mbledhjen e 18-të të KQZ-ës. A ka dikush diçka lidhje me rendin e ditës? Nëse jo, kush është për këtë rend dite. Fillojmë më procesverbalin e mbledhjes së 08. A ka dikush vërejtje në këtë procesverbal? Nëse nuk ka vërejtje. Kush është për miratimin e këtij procesverbalit Miratohet. Faleminderit, vazhdojmë më aktivitetet se SKQZ-ës.

2.Aktivitetet e SKQZ-së

Burim Ahmetaj: Sekretariati është në procesin e përgatitjeve dhe po ashtu është në fazën po thuajse finale të përgatitjeve për organizimin e zgjedhjeve të 14 shkurtit që do të mbahen ditën e diel. Në kuadër të shërbimit votues është duke vazhduar pranimiti i pakove të supozuara nga postat e Kosovës, deri me tani janë pranuar 14.625 pako më fletëvotime të supozuara, në bashkëpunim më të gjitha postat jemi duke e bërë këtë procedurë po thuajse të njëjtën në të gjitha postat me komision për ti marr dhe më persona të autorizuar për ti marr pakot më fletëvotime. Gjatë ditës së djeshme sipas raportit 362 pako më fletëvotime të supozuar nga qendra tranzitore e Kosovës dhe totali deri me tani është 14.625 pako më fletëvotime të supozuara. Gjatë ditës së sotme kemi kontaktuar po ashtu më të gjitha postat dhe është konfirmuar se në posten e shpejtë TNT dhe U5, kemi një sasi të pakove të cilat mund të i tërheqim ndërsa DEHAEL na është konfirmuar që aktualisht nuk do të mundemi sepse do të na njoftojnë më kohë, për kohën e tërheqjes. Kështu që kjo është po ashtu në bashkërendim edhe më DEHAEL-in. Ndërsa në komunikim të vazhdueshëm jemi edhe më posten e Kosovës dhe në baza ditore jemi duke bërë tërheqjen e të gjithave pakove të cilat do të dërgohen në vendin e mbajtjes në Ministrin e Infrastrukturës është lokacioni ku mbahen të gjitha pakot. Jemi njoftuar nga posta e shpejt DEHAEL se një zarf i cili nuk i takon fletëvotimeve të supozuara por i takon një klientit të postes

është gabimisht në mesin e pakove dhe për këtë është kërkuar që të mundësohet tërheqja këtij zarfi apo kësaj pakos, sekretariati i është përgjigjur pozitivisht dhe do të të ja mundësoj postes së shpejtë DEHAEL mundësin e tërheqjes e kësaj pakos sepse është më e lehtë të veçantë për klientin e kësaj poste, për këtë është ngritur një komision po ashtu duhet të njoftohet edhe të gjithë vëzhguesit për momentin së kur do të behet tërheqja e kësaj pakos sepse e kanë identifikuar në korrespondencat të cilat i kemi dërguar email e keni të saktësuar, faktikisht pako konsiderohet një zarf por në atë zarf mund të këtë edhe një zarf tjetër, por si do qoftë është terminologji që e përdorim si sekretariat. Ai është një zarf i cili nuk është i adresuar për KQZ, është e një klientit të postes, dhe është kërkuar të mundësohet tërheqja e këtij zarfit, i kemi marr masat dhe do ti ju mundësohet tërheqja e atij zarfi në praninë e një përfaqësuesi të kësaj postes dhe të vëzhguesve.

Më datën 10 shkurt, është nisur kontingjenti më fletëvotime dhe broshura nga kompania nga e cila është bërë edhe shtypja e paketimeve të fletëvotimeve dhe më datën 12 diku paradite do të behet arritja e fletëvotimeve në Kosovë të cilat do të dërgohen në QNR, vendi ku do të mbahen përkohësisht dhe shpërndarja e tyre do të behet me datën 13 shkurt, pasi që janë material i ndjeshëm, pra ditën e shtunë do të behet shpërndarja e fletëvotimeve. Në aspektin e trajnimeve sekretariati është duke në trajnimin e trupave zgjedhor të atyre që duhet të angazhohen si këshilla të vendvotimit, stafit teknik po ashtu dhe stafit që angazhon në proceset zgjedhore, deri me tani janë trajnuar 12.930 anëtar të këshillave të vendvotimeve, keni edhe tabelën të bashkangjitur për trajnimin nëpër secilën komunë, kemi mungesa mirëpo e kemi edhe në plan trajnimin plotësues, ku do të trajnohen secili anëtar i këshillave të vendvotimeve që mungojnë për arsye objektive, po ashtu edhe të gjithë anëtarët të cilët zëvendësohen dhe do të ju mundësohet trajnimi i të gjithë anëtareve të këshillave të vendvotimit, bashkangjitur e keni edhe raportin për secilën komunë dhe trajnimin e këshillave të vendvotimeve. Trajnimi i kryesuesve të vendvotimeve dhe menaxhereve të qendrave praktikash është takim koordinues do të ndodh më datën 12 dhe 13 shkurt ku të pranishëm sigurisht që kanë shprehur vullnetin edhe prokuroria e Kosovës të jenë të pranishëm në këto takime që do të mbahen koordinues në mes kryesuesve të këshillave të vendvotimit dhe menaxhereve të qendrave të vendvotimit.

Në aspektin tjetër, është duke u zhvilluar trajnimi i stafit të shërbimit votues të cilët do ta bëjnë vlerësimin e pakove të fletëvotimeve përmes postës, paketat do të transportohen ditën e diel nga vendi i mbajtjes në QNR dhe diku paradite do të fillojë edhe puna e vlerësimit të pakove të fletëvotimeve përmes postes dua do të njoftohen edhe vëzhguesit për këtë proces kur edhe do të fillojë dhe gjithë procesi do të behet në prani të vëzhguesve. Ndërsa trajnimi i stafit e Rezultateve preliminare faza parë është përmbyllur janë trajnuar deri më tani 830 staf, që i bje 830 qendra të votimit janë të trajnuar ndërsa pjesa tjetër do të vazhdojë nesër, është trajnim plotësues për stafin të cilin nuk kanë mundur të arrijnë të ndjekin trajnimin në kohën të cilën e kemi parapa dhe trajnimi i stafit të QNR-ës do të

zhvillohet ditën e premte dhe ditën e shtune, të gjitha këto janë ne aspektin e trajnimit të trupave zgjedhor në mënyrë që të përgatitemi për ditën e zgjedhjeve. Ndërsa sa i përket materialeve zgjedhore të cilat do të shpërndahen në komuna qofshin furnizime apo shërbime të cilat i kemi ky proces do të vazhdojë më datën 12 dhe 13 shkurt, materialet të ndejshme të cilët janë fletëvotimet dhe listat përfundimtare të votuesve do të shpërndahen ditën e shtune neper secilën komunë dhe materialet tjera siç janë pakot më fletëvotime, pakot për secilin vendvotim që përfshin formularët zgjedhor, edhe materialet tjera zgjedhore, materialet antikovid për secilën qendër dhe secilin vendvotim pra edhe këto materiale do të shpërndahen ditën e shtune. Sekretariati i ka marr të gjitha masat në mënyrë që të përgatitet si në aspektin e trajnimit po ashtu edhe në aspektin e furnizimeve të gjitha komunave dhe të gjitha qendrave më materialet të cilat do të përdoren në ditën e zgjedhjeve. Kaq sa i përket aktiviteteve të sekretariatit, nëse keni pyetje jemi të gatshëm të ju përgjigjemi.

Sami Hamiti: Unë vërejta një gabim teknik që e keni në tabelën dhe në referimin tuaj për zarfet që kanë ardhur deri me tani nuk janë 14.625 por janë 14.987, nuk e keni përditësuar shumën e fundit e pash që po përsëritet, dje që i keni marr plus është 362 që në plotin janë 14.987 zarfe. Për shkaqe të një sqarimi sepse unë dje e pash neper media dy interpretime të ndryshme që asnjëra nuk ishte e sakët, njëra që kanë arritur 14.625 në njërin nga portalet, në një tjetër ka qenë 14.000 vota. Këto janë zarfe që ne vetëm mundemi të supozojmë, sepse nuk e dimë ende pa filluar vlerësimi i tyre sa ka vota, sepse nuk mundemi ta dimë sa të hapen. Ka mbërritur 14.987 zarfe që supozohet sepse nuk e dimë sa ka vota, po as nuk janë 14.000 zarfe. Interpretimi i sakët, është që deri më tani kanë mbërrirë 14.987 zarfe që janë në KQZ.

Sami Kurteshi: Reagimi ishte i drejtë sa i përket shifrave por ai është gabim teknik. Kam 2 pyetje që janë konkrete, 1 për shkak të mesazheve që i marrim ne vazhdimisht është kërkuaka këtu që publikohet lista e personave të refuzuar, lista përfundimtare pas apeleve dhe ankesave në PZAP, lista përfundimtare e personave që janë pranuar, që kanë të drejt ta dërgojnë votën dhe natyrisht që këto dy lista madje duhet të përputhen sepse me gjasë ka njerëz që nuk e dinë, nuk e shohin veten në listën e atyre që kanë aplikuar suksesshëm dhe janë konfirmuar por nuk e dinë a ka të drejt sepse ka njerëz që ju është than që aplikimi juaj është konfirmuar po nuk shihet në listën e të pranuarve, kjo është një problem dhe prandaj kishte me qenë shumë e drejt edhe kërkesa ishte dje apo pardje që të publikohet përfundimisht lista përfundimtare e personave të refuzuar, të e gjejnë emrin e tyre dhe e din saktësisht dhe në anën tjetër pas ankesave në PZAP të publikohet lista përfundimtare e atyre që ju është lejuar për të votuar. Në këtë kuptim kisha më thanë një pyetje, a keni ju ndonjë informacion se mund të ketë keqpërdorime për shkak të këtyre ngatërresave, Sa i përket listave apo aplikimeve, dokumenteve dhe e 2-ta që është përsëri krekës për KQZ-n jo për sekretariatit, pikërisht duke i marr këto parasysht këto

çfarë i thash kjo vonës që është e çfarëdo natyre të jetë , që njerëz nuk e kanë ditur përfundimisht aplikuesit në cilën listë janë.

Përsëri, tha z. Kurteshi, unë kërkoj nga KQZ-ja që data 13 shkurt, të jetë datë deri kur pranohet posta më fletëvotime nga jashtë, qëllimi është legjitim, ekzistenca e KQZ-ës është vota pranimit i votave dhe rregullimi i votës, ne kemi vonesa të tilla si KQZ me vendimet tona i kemi bërë ato për shkaqe teknike që kanë qenë shumë aplikime, shumë probleme më ankesa, pa ankesa sekretariati ka publikuar listat e atyre që janë pranuar, ka prej tyre që janë konfirmuar por nuk janë pranuar po edhe ata që nuk e dinë prandaj krekës ime edhe njëherë është që KQZ-ja ta marr vendimin që posten ta pranoj më 13 shkurt sepse ajo nuk e dëmton në asnjë mënyrë vota që hidhet më 14 shkurt në Kosovë sepse ka ardhur para asaj vote.

Burim Ahmetaj: Po ndërlihem më atë që e tha z. Hamiti së pari është një gabim teknik, mirëpo edhe publikimi apo shifrave të djeshme ka qenë po thujse një gabim teknik që i është kërkuar edhe portaleve që të përmirësojnë që, të i referohen raportimeve të sakta nga KQZ-ja dhe konfirmojmë që pas permisimit nga z. Hamiti të këtij detajit teknik 14.987 zarfe më fletëvotime jashtë vendit janë të ardhura deri me tani në objektin e KQZ-ës. Ndërsa sa i përket pyetjeve që i ngriti z. Kurteshi jemi konsultuar edhe më shërbimin e votuesve dhe me bartësit e këtij divizionit dhe lista e votuesve të cilët nuk janë pranuar, faktikisht i bije ata që janë të refuzuar, ata sipas procedurave asnjëherë nuk janë publikuar dhe kjo ka qenë ajo zbrazëtitrat që ndoshta ka mundur më ngrit konfuzion tek votuesit të cilët nuk kanë mundur ta gjejnë veten në listën e votuesve jashtë vendit të konfirmuar. Të gjithë ata që nuk e gjejnë veten në listën votuese dhe jashtë vendit të konfirmuar, praktikisht janë në listën përfundimtare të votuesve brenda vendit, ndoshta mund të ketë edhe gabime teknike jemi duke rishikuar vazhdimisht dhe të gjitha vendimet e PZAP-ës të cilat kanë ardhur sekretariati i ka trajtuar dhe i ka publiku kohë pas kohe sipas vendimeve që kanë ardhur dhe janë të publikuar në ueb-faqe. Sa i përket listës e votuesve të cilët kanë aplikuar për tu regjistruar dhe ju është refuzuar aplikimi nuk kemi procedurë që e bën publikimin e tillë. Këtë konfirmim e kam marr nga bartësit e shërbimit votues që nuk ka ndonjë procedurë të tillë.

Alim Rama: Kjo qasje kështu që nuk kemi procedurë, kjo vetëm e rrit jo transparencën së punës së KQZ-ës, krijimi i një procedure të thjeshtë e cila publikon 30.00 apo 27.000 për afërsisht unë nuk po e shoh si problem dhe po e shoh si një tendencë e vazhduar që KQZ-ja ta zvogëlojë transparencën të cilën e ka të obligohem në bazë të ligjit. Sa i përket votave të cilat vinë unë veç isha ndërlihur më këtë pyetje e kërkesës së z. Kurteshi edhe në bazë të planit të sotëm, pranimit i zarfeve deri 12 shkurt në mesnatë, unë nuk po shoh arsye dhe nuk e pash në planin të rekomanduar nga KQZ-ja ku pranohen ato vota që vinë 23:59 sepse aty ka qenë deri në orën 02:00 ose ora 03:00, kështu që rrjedhimisht i

bijën se ato vota në çdo mënyrë do tërhiqen dhe unë pres nga sekretariati të na tregoj kohën se kur do tërhiqen ato vota. Ndërsa sa i përket kësaj polemikes së kur është koha e fundit, ne e kemi një ligj dhe unë po e shoh këtu kokëfortësinë nga anëtarët e KQZ-ës me thye ligjin, nuk kemi të drejt si anëtar të KQZ-ës ta thyem ligjin me votën sepse ligji thotë një ditë parazgjedhjeve, ne mundemi me debatua për kohën a është koha 15:00,17:00 a 19:00 e cila do orë por është një ditë parazgjedhjeve dhe ajo është e vetmja ligjore. Kryesuese unë e di se KQZ-ja dhe ju personalisht keni votuar kundër që të tërhiqen zarfet nga postat e shpejta por ka pasur ndikim nga jashtë dhe u ndërrua vendimi, unë kërkoj që KQZ-ja mos të veproj nga ndikimet nga jashtë por të i merr vetëm vendimet brenda të cilat janë të ligjshme.

Këto tendenca me javë të tera, vetëm edhe vetëm të thyhet ligji, janë papranueshme. Edhe, e papranuar po ashtu, me një nga trajnimet dje. Edhe unë, këtu po ju referohem sekretariatit që i kërkojë të i merr masat e menjëhershme që disa anëtarët të këshillave kanë than: dhe unë kërkoj që të gjithë anëtarët e këshillave të vendotimeve ose ne që ju referohemi si komisioner të vetmen punë kanë që të e zbatojnë ligjin dhe e citoj se çfarë ka than njeri nga ata anëtarët dhe, unë kërkoj sekretariatit që të ndëshkoj dhe të bën zëvendësimin e tij, "do të rrehemi dhe do të bëhemi copa dhe nuk do të lejoj numërimin e as qitjen në formular të kandidatit z. Albin Kurti"! Kjo, është e pa pranueshme anëtarët e këshillave kanë për obligim që të e zbatojnë doracakun dhe manualin e trajnimit i cili është aprovuar nga ky institucion, vetëm kjo mënyrë që të krijohen keq kuptimet që të prishet procesi, që të paralajmërohet prishja e procesit nuk është e tolerueshme. Sa i përket në raportin që e kemi kërkuar kemi than publikimi i listës së votuesve është në orën 19:14 dhe kjo duhet të evidentohet, unë nuk po e shoh se ku e ka marr referencën PZAP-ja dhe jo vetëm publikimi por edhe vendimi, takimi ka përfunduar rreth asaj kohe ndërsa vendimi është nënshkruar vetëm pas mbledhjes se nuk ka mundur njoftimi të nënshkruhet derisa nuk ka përfunduar mbledhja sepse të gjithë kemi qenë në mbledhje dhe mbledhja ka qenë publike, unë nuk e di kush ka komunikuar në emër të institucionit me PZAP që të merr kohën e sakët ose PZAP-ja në mënyrë absurde e kanë marr që në ora 18:00 edhe posaçërisht për një institucion i cili duhet të i apeloj të gjitha ankesat në proces merr kohë dhe merr vendime i trajton deri në mesditë deri sa të behet publike se pastaj thonë që ne nuk i pranojmë ankesat..

Valdete Daka: T'i, deri sa ju drejtohesh me pyetje një institucioni tjetër i cili nuk është këtu prezent mu me duhet që të ndërpresë! Nëse ke pyetje për PZAP, i drejtohesh PZAP-së jo neve, ne nuk mundemi më dhene përgjigje për PZAP-n.

Alim Rama: Kush ja ka dhen informatën PZAP-ës që koha e vendimit është në ora 18:00, dhe prej nga e kanë marr ata kohën që është për ankesa në orën 18:00. Në përgjigjen e PZAP-ës që e morëm ne për

rastin e certifikimit të listave ka qenë që PZAP-ja komunikon vetëm me Kryesuesen dhe është një çështje tjetër legjitime të cilën ju e keni bërë se e keni nënshkruar letrat në emër të KQZ-ës pa vendim të KQZ-ës dhe për ato ne vazhdojmë me tutje. Ju keni nënshkruar vendimet e KQZ-ës në të cilat nuk janë votuar të certifikimi i kandidateve, arsyetimet kush i ka votuar.

Valdete Daka: Vendimet nuk kanë qenë unanime, ato që janë unanime dhe duhet të tregojmë pse nuk janë unanime.

Alim Rama: A kemi votuar ne për atë arsyetim?

Valdete Daka: Kurrë nuk kemi votuar ne për arsyetim. KQZ-ja nuk po funksionon prej ditës kur ke ardhur ti, kjo funksionon shumë me herët dhe asnjë arsyetim nuk është votuar. Problemi është që ju doni të e kontrolloni çdo send.

Alim Rama: Pika e 3-të, ne e kemi diskutuar edhe në KOZ por nuk i takon këshillit vetëm e kemi ngritur si çështje nuk ka pasur informim të mjaftueshëm dhe desha të ju referohem z. Ahmetaj sa persona të janë lajmëruar deri me tani që janë më infektuar më KOVID sepse ajo ka qenë kërkesa që të raportoni këtu dhe ne nuk e kemi marr atë raport, cilët janë ata persona a kemi marr të dhënat e sakta nga IKSH-ja dhe a i kemi publikuar informatat e mjaftueshme sepse ka pasur edhe brenga nga qytetaret që nuk kanë informata të mjaftueshme si do të votojnë ata ditën e zgjedhjeve, në këshillin për informim publik ne kemi trajtuar, janë publikuar materiale por siç po duket nuk ka informatë të mjaftueshme.

Sami Hamiti: Ne po sillemi në vazhdimësi në çështjen që po na mbahet ligjërata për ligj këtu, dua të ju them edhe kolegeve të mi çështjen e ligjit dhe çështjen që po na mbajnë ligjërata në çdo mbledhje që afati është një ditë përpara, është çështje që këta mendojnë ashtu ligji e përcakton ndryshe por nëse këta kanë dilema mos të na mbajnë ligjërata, prandaj është balancimi i pushteteve ekziston, le të shkojnë që ta e dërgojnë në PZAP, apo në gjykatë dhe mos të na ligjërojnë këtu sepse e kanë tepruar. Prandaj ekziston PZAP-ja, edhe Gjykata supreme dhe le të ecin tutje. Është e tepërt ne çdo takim, në çdo mbledhje më na mbajt ligjërata, se këta janë më ligj e nuk vazhdojnë tutje, ter kohën flitet këtu për një institucion tjetër, munden të ju referohen PZAP-ës, le të ankohen aty prandaj janë ato institucione.

Burim Ahmetaj: Unë, e kam një krekës personale për ju Kryetare, është mirë që të respektohet rregullorja e punës të KQZ-ës edhe sa i përket marrjes së fjalës dhe atëherë kur ne vetëm devijojmë nga pika e rendit të ditës, të kthehemi në respektimin e rregullores dhe të ecim përpara me rendin e ditës të cilin e kemi miratuar pak më herët.

Sami Kurteshi: Megjithatë unë po e shoh pak si problematike që kur ngritja e çështjeve ka të bëjë me KQZ-n quhet ligjëratë apo quani si te doni, ne kemi të drejtën më diskutua për çdo çështje që ka të bëjë me KQZ-n, asnjë çështje private nuk e kemi ngritur këtu. Znj. Kryesuese ju deklaruat që ne po dojmë me e kontrollua KQZ-n, ka mundësi që të keni edhe këtë perceptim. Duhet të i tregoni publikut dhe KQZ-ës cilat janë veprimet tona që ju mund të i konsideroni si kontroll të KQZ-ës, ky institucion ekziston që 20 vite dhe po ne po ngrisim çështje dhe ka ndryshuar diçka. Ky institucion nuk është më makinë votimi, ne po ngrisim çështje që kanë të bëjë me KQZ-n nëse e tregoni vetëm një rast të përpjekjes së kontrollit ashtu siç e bëni ju mund të tregoni konkretisht. Unë konsideroi se ju znj. Kryesuese e keni monopolizuar këtë institucion dhe fakti që ne ngritëm çështje që nuk përkasin më monopolin që keni krijuar ju, ju e quani ligjëratë bashkë me bashke partiaket të tjerë. Znj. Kryesuese ju keni marr vendime që nuk janë të KQZ-ës, ju keni shkruar letra në emër të KQZ-ës që nuk i ka miratuar KQZ-ja, ju keni bërë reagime në emër të KQZ-ës që nuk i ka miratuar KQZ-ja, ne kemi ngritur çështje që janë të KQZ-ës dhe asnjë nuk është private dhe ju i quani përpjekje për kontroll. Përpjekja për transparencë totale në këtë institucion nuk është kontroll, ju mundeni ta gjeni kush do nga ju një përpjekje, një veprim konkret të Sami Kurteshit si anëtar i KQZ-ës, të Alim Rames si anëtar i KQZ-ës për kontroll në këtë institucion apo çfarëdo kontrolli. Nëse ju e quani kontrolli kërkesën për transparencë me e publikuar listën e personave që janë refuzuar, kërkesën që a keni informatë se ka keqpërdorime të dokumenteve personale, të listave, të njerëzve që janë në lista dhe nuk janë në lista nuk është kjo ligjëratë, kjo është kërkesë konkrete për transparencë nuk është për kontroll sepse nuk ka të bëjë me emrin tim.

Burim Ahmetaj: Duke u ndërlidh me atë që e kërkojë Z.Rama, faktikisht lista e votuesve jashtë vendit më konkretisht votuesit të cilët janë refuzua dhe nuk mund të jenë në listën e jashtë vendit ata janë në listën brenda vendit. Kështu që nuk kemi heq asgjë prej asaj liste kështu që ata janë praktikisht në listën përfundimtare të votuesve. Mirëpo procedura nuk na lejon me publiku listën që sa vite, tash jemi në vitin 2021 dhe asnjëherë nuk është publikuar lista e votuesve jashtë vendit, personave apo aplikuesve të cilëve ju është refuzuar votimi jashtë vendit. Mirëpo ju siguroj që ata praktikisht janë në listën e votuesve, listën përfundimtare të votuesve brenda vendit.

Ndërsa, sa i përket heqjes së votave, kohën kur do ti tërheqin votat, na jemi në komunikim të vazhdueshëm me të gjitha postat dhe na e kemi obligim qysh është përcaktuar me ligj që na deri në mes natë patjetër duhet me komunikua me secilën postë edhe me I tërheq dërgesat e fundit, kështu që nuk përfundon puna jona apo e postave në ora 13:00 apo 15:00 ose 17:00, mirëpo na kemi obligim deri në minutën e fundit me tërheq votat. Kështu që për këtë arsye jemi që 2 javë apo me shumë jemi tu punua me 2 ndërrime që praktikisht të punojmë deri në mes natë që ta kryejmë këtë shërbim. Pra tërheqja do të bëhet deri në minutën e fundit nëse ka zarfe të cilat janë të adresuara për në KQZ-së. Ndërsa për ata që me u ndërlidh me pyetjen e Z.Rama dhe pyetjen e Z.Selmani sekretariati është në

lidhje me personat e infektuar me Covid, sekretariati është në komunikim të vazhdueshëm me shtabet emergjente nëpër secilën komunë, mirëpo jo të gjitha rastet kanë mundur ti evidentojnë shtabet lokale apo shtabet komunale. Dhe kemi ardhur në përfundim si alternative tjetër që do ta mundësojë ma lehtë marrjen e informatave është në bashkëpunim me shtabet emergjente dhe me zyrtarët tonë komunal të publikohen edhe adresat, edhe numri i telefonit, në mënyrë që të paraqiten vullnetarisht që do të na ndihmonte neve...

(P.s. Nuk ka incizim të mëtutjeshëm të mbledhjes. Stenogrami, është i papërdorshëm dhe, nuk është i vlefshëm për shkaqe teknike.)